

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “KEI AUDITING & CONSULTING” SHPK

Neni 1:

Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit

Sot, me 17.01.2024 në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligiit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligiit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", Ne, themeluesit, kemi krijuar, nje Shoqeri Tregtare me emërtimin “KEI AUDITING & CONSULTING” shpk, si shoqeri me pergjegjësi te kufizuar të së drejtës shqiptare me, Ortakë te shoqërise:

1. Zj. Iris Qirjaqi, atësia Koço, amësia Eftali, lindur me 17 gusht 1988 në Shkodër, Shqipëri, shtetase shqiptare, banuese ne adresen: Rruga Skender Luarasi, Ndertesa 3, hyrja 6, Tiranë, Shqipëri
2. Zj. Eftali Qirjaqi, atësia Kolë, amësia Sose, lindur me 01 janar 1959 në Sarandë, Shqipëri, shtetase shqiptare, banuese ne adresën: Lagje Vasil Shanto, Shkodër, Shqipëri

Neni 2:

Objekti

Shoqëria me Përgjegjësi te Kufizuar " KEI AUDITING & CONSULTING" shpk, do të zhvilloje aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

1. Auditimin ligjor dhe vullnetar të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara
2. Sherbime te Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura
3. Sherbime te kontabilitetit. Sherbimet e mbajtjes se kontabilitetit, konsulence kontabel mbi standardet kombetare kontabilitetit dhe nderkombetare te raportimit financiar, pergatitja e pasqyrave financiare. Ngritja, permiresimi dhe mirembajtja e sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendshem te njesive ekonomike si dhe trajnimin profesional te personelit qe eshte ngarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve.
4. Sherbime fiskale. Konsulenca fiskale per njohjen dhe zbatimin e legjislacionit fiskal, deklarimet tatimore.
5. Pergatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave te drejtuesve te biznesit si raporti i ecurise se veprimtarise, raporti I drejtimit te brendshem, planeve te biznesit, raportet e kostos etj
6. Sherbime te tjera te lidhura me shoqerite tregtare, si: Regjistrimi i biznesit, transferim i veprimtarise ekonomike, mbyllje biznesi me proceduren e likuidimit; rritje dhe zvogelim kapitali; ekspertize gjyqesore
7. Organizimi i kurseve te trajnimit profesional ne fushen e kontabilitetit dhe legjislacionit tatimor.
8. Sherbime te tjera ne fushen financiare.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e shoqërise tregtare "KEI AUDITING & CONSULTING" shpk, është e pakufizuar.

Neni 4:

Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

Selia e shoqerise Tregtare KEI AUDITING & CONSULTING sh.p.k. eshte ne Tiranë, ne adresen: Rruga Skender Luarasi, Sheshi Gjeneral San Jozef Martin, Ndertesa 3, Hyrja 6, Tirane, Shqiperi.

Adrese tjeter e ushtrimit te aktivitetit eshte: Lagjja Qemal Stafa, Rruga Studenti, godine 7-kateshe, kati 1-re, me nr pasurie 35/1, zona kadastrale 8591, Shkoder, Shqiperi

Te dhenat për qellimin e komunikimit elektronik jane si vijon:

Telefon 1: +355689055228

Telefon 2: +355692069434

Email 1: qirjaqi.iris@gmail.com

Email 2: elirqirjaqi@yahoo.com

Website: www.keiauditing.com

Emri tregtar i Shoqerise: QIRJAQI Auditing & Tax

Neni 5:

Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

(1) Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjesi të kufizuar KEI AUDITING & CONSULTING, eshte 100,000 (njëqind mijë) Lekë i përbërë nga dy kuota.

(2) Themeluesit marin në pronesi kuotat e tyre ne kapitalin themeltar në perputhje me kontributin e tyre. Kontributi i ortakeve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Ortaku Themelues: Iris Qirjaqi, zoteron një kuote të cilës i korespondon 76 % të vlerës së kapitalit. Vlera e zoteruar 76.000 lekë

Ortaku Themelues: Eftali Qirjaqi, zoteron një kuotë të cilës i korespondon 24 % të vlerës të kapitalit. Vlera e zoteruar 24.000 leke

(3) Kapitali eshte ne para. Nuk ka kapital ne natyre.

(4) Kapitali nuk eshte shlyer akoma ne para. Kapitali do te shlyhet me regjistrimin e Shoqerise dhe hapjen e llogarise bankare biznesi per Shoqerine.

Neni 6

Organi vendimmarres

Në baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i larte vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët, përfshirë edhe ata që nuk marrin pjesë në votim dhe që votojnë kundër këtyre vendimeve.

Vendimet për çështiet e mëposhtme të Shoqërisë mund të miratohen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të ortakëve ose nëpërmjet konsultimit me shkrim:

- Përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- Miratimi i ndryshimeve të Statutit;
- Emërimi e shkarkimi i administratorit si dhe përcaktimi i kompetencave dhe shpërblimit të tij;
- Emërimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar (audituesve ligjore) si dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre;
- Mbikqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire mbikëqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise së veprimtarisë;
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës dhe brenda gjashtë muajsh nga përfundimi i vitit financiar;
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës;

- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Caktimin e përfaqesuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- Miratimin e riorganizimit të shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e shoqërisë, shndërrimin e shoqërisë si dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë të ortakëve.

Neni 7:

Administrimi

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë se një person fizik si administrator të shoqërisë. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës së zakonshme, të kapitalit themelues. Nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

(2) Shoqëria do të drejtohet nga administratori i zgjedhur nga mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme, i cili emërohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorë të shoqërisë janë: 1) Iris Qirjaqi me te drejta të plota.

(3) Administratori/et kane keto të drejta dhe detyrime:

- të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë, në mënyre aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me leshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokatë mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarreveshje; të lëshojnë ose të revokojnë mandate avokatëve dhe mbrojtësve dhe punonjësve të shoqërisë ose të tregtarëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;
- të kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata leasing; operacione cedimi kredie) aktive dhe pasive që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përmbushje të formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dorëzimin,
- të çelin llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pageses, të firmose çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti, të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;
- të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;
- të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- të lëshojë vërtetime që lidhen me personelin; të kujdeset për respektimin të drejtave ndaj të cilave shoqëria është e detyruar:
- të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësira nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;
- të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e konçesioneve, liçencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;
- të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumatat e depozituara pranë saj;
- të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
- të kontrollojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënien bankare, duke rënë dakort mbi afatet dhe kushtet;

- të kryej çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumentave të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- të përfaqësojë shoqërinë në asamblетë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.

Administratoret mund të kryejnë individualisht të drejtat e sipercituara. Nuk është i detyrueshem dhe i nevojshem vendimi i përbashkët me unanimitetin ose prezencën fizike e njëkohshme e të dy administratorëve për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të administratorëve.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

Emrat dhe nënshkrimet e ortakëve themelues të:

Shoqërisë Tregtare "KEI AUDITING & CONSULTING" shpk

Iris Qirjaqi



Eftali Qirjaqi

